

Endrra historike siameze e disa milione shqiptareve per te kqyrur kryeministrin Sali Berisha ne bursen e NASDAQ tashme eshte bere realitet. Ky premtimi me madhor i fushates qe nga viti 2005 qe u permbush me 20 Shtator me vullnetin e vete kreut te Keshillit te Ministrave.org

Qindra sms nga biznesmene amerikane ku Berisha lutej te vizitonte NASDAQ dhe ftesat insistuese nga vete drejtuesit e burses e binden kryeministrin Sali te bente kete qoke meshire ku ne perfundim mbylli edhe bursen e cila nga gezimi i llahtarshem u mbyll me nje fitorje historike.



Pas largimit te kryeministrit Sali nga ambjentet e burses amerikane, bordi drejtues i NASDAQ ndikuar nga efekti cudiberes i Berishes, kane pleqeruar problemet e brendshme te burses, krizes boterore dhe ne fund te mbledhjes kane dale ne disa konkluzione.

NASDAQ i duhet nje drejtues qe di ti jap drejtim punes, nje njeri i sukseshem, praktik dhe mbi te gjitha person me ndergjegje dhe i ndershem. Pra bursa amerikane kerkon nje njeri qe punon shume dhe kerkon pak dhe ajo qe eshte me e rendesishme, te urroje korrupsionin dhe te kete prioritet rimekembjen e Amerikes.

Sukseset historike te liderrit siamez shqiptar pra kryeministrit Sali jane deshmi e qarte se i ploteson te gjitha kushtet per te qene president bordi i NASDAQ.

“Madje kjo duhet bere sa me shpejt, para se kongresmenet amerikane ta propozojne si kandidature per president te Shteteve te Bashkuara” theksoi nje specialist i burses.

Prandaj unanimisht bordi drejtues i NASDAQ vendosi si me poshte vijon:

- **NASDAQ i nderrohet emri ne SALDAQ**
- **Kryeministrit Sali i propozohet posti i presidentit te SALDAQ**
- **Rroga do te jete honorifikisht 1 milion dollare ne muaj**
- **Pushimet verore presidenti i SALDAQ do ti beje ne plazhin e Florides qe i ngjan aq shume Dhermiut.**
- **Keto vendime hyjne ne fuqi menjehere sapo presidenti i SALDAQ te kete miresine ti pranoje.**